Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/103
Datë 04.03.20

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2020 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet Instituti për aftësim profesional dhe përkrahje të punësimit "Dituria" me adresë Rr. Shaip Spahia Nr. 46 Prizren, për periudhën tri vjeçare 25.02.2020 deri 24.02.2023 për të ofruar vlerësuar dhe certifikuar këtë kualifikim të validuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve:

   1.1. **Murator dhe punëtorët e ngjashëm, Niveli III sipas KKK me 57 kredi të AAP; Numri i kandidatëve i lejuar për grup: 12 kandidatë.**

A r s y e t i m

2. Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime, janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacioni për akreditim si institucion ofrues dhe/ose Vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raporti i

Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi. Numri i kandidatëve i lejuar për grup është bazuar në hapësirën fizike, pajisjet dhe mjetet e punës për ushtrimin praktik. IAAP Dituria ka drejtë të ofrimit, vlerësimit dhe certifikimit të këtij kualifikimi në periudhën prill-shtator.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Instituti për aftësim profesional dhe përkrahje të punësimit "Dituria"
- AKK

Kryetarja e KD të AKK-së
Violeta Dema